

EKONOMIA NDËRKOMBËTARE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Departamenti I Shkencave Politike
Titulli i lëndës:	Ekonomia ndërkombëtare
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Parë (I-rë)
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Sejdi Rexhepi
Detajet kontaktuese:	sejdi.rexhepi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<i>Ekonomia Ndërkombëtare merret me studimin e ekonomisë botërore, dallimeve që ekzistojnë në burime, diferencave në nivelin e zhvillimit ekonomik, arsyet, nevojat dhe format e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar, tregtinë ndërkombëtare, financat ndërkombëtare, investimet dhe migrimin ndërkombëtarë të popullsisë, sikurse edhe të institucioneve ndërkombëtare.</i>
Qëllimet e lëndës:	
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Që studentëve të ju ofrohen njohuri të thella, mjaftë të kompletuara, të përmbledhura dhe të azhurnuara lidhur me Ekonominë dhe Politikën Botërore. 2. Që studentët të plotësojnë dhe rrisin njohuritë e tyre <ol style="list-style-type: none"> a. për ekonominë dhe politikën botërore, politikat e bashkëpunimit ekonomik dhe të tregtisë ndërkombëtare, si dhe proceset e përgjithshme të integritimit që janë të lidhura me qarkullimin e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe financave ndërkombëtare. b. për pikëpamjet kryesore që kanë të bëjnë me tregtinë ndërkombëtare,

	<p>këmbimin monetar dhe shoqëritë shumëkombëshe dhe politikën përkatëse që i ndjekin shtetet lidhur me bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar.</p> <p>c. për proceset e përgjithshme ekonomike ndërkombëtare siç janë format e ndryshme të integritit ekonomik duke filluar nga zona e lirë tregtare, bashkëpunimi doganor, tregu i përbashkët dhe bashkimi ekonomik si dhe të identifikoj rolin dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare në këtë proces.</p> <p>3. Që Studentët të aftësohen</p> <p>a. për hulumtime dhe studime të pavarura në fushën e ekonomisë dhe politikës botërore.</p> <p>b. për aplikimin praktikë të kornizës teorike të Ekonomisë dhe Politikës Botërore me rastin e interpretimit të ndodhive dhe transaksioneve që reflektojnë në përmasa botërore.</p> <p>për studim dhe vështrim kritik si dhe për nxjerrjen e përfundimeve të pavarura profesionale dhe shkencore në fushën e ekonomisë dhe politikës botërore.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kenë dije dhe aftësi të mjaftueshme për të hartuar dhe zhvilluar mendime dhe koncepte personal lidhur me forcat kryesore shtytëse të ekonomisë botërore bashkëkohore duke filluar nga interpretimi klasik i faktorëve shtytës të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtarë deri te interpretimi bashkëkohor. 2. Që aftësitë dhe dituritë e fituara të mund ti përdorin në mënyrë kreative për të njohur, kuptuar, krahasuar, analizuar dhe për të zhvilluar mendimin profesional dhe kritik lidhur me dukuritë e ndryshme në Ekonominë dhe Politikën Botërore.

	<p>3. Që të analizojnë në mënyrë të pavarur duke u mbështetur në metodologjinë profesionale dhe shkencore dukuritë dhe ecuritë e përgjithshme në ekonominë dhe politikën botërore.</p> <p>4. Që të studiojnë në mënyrë të pavarur duke u mbështetur në metodologjinë profesionale e shkencore dukuritë dhe ecuritë e përgjithshme në ekonominë dhe politikën botërore</p> <p>5. Që të nxjerrin përfundime të pavarura profesionale dhe shkencore lidhur me ecuritë dhe dukuritë e përgjithshme në ekonominë dhe politikën botërore</p>
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	15	30
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet ,etj.	1	10	10
Totali			175

Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>a).Qasja është e bazuar në pjesëmarrjen aktive të studentëve</i></p> <p>1. Mësimdhënësi shpjegon objektivat e</p>
-------------------------------------	--

	<p>mësimi studentëve përmes ligjëratave,</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Përmes tabelës, projektorit dhe formave tjera vizuale prezantohen teoritë dhe konceptet kryesore 3. Mësimi i kombinuar interaktiv do të përdoret 4. Konkludime të përbashkëta do të nxirren përmes diskutimit të pyetjeve dhe çështjeve të ngritura. <p>b). Aktivitetet Grupore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Tryeza pune, diskutime grupore, prezantime grupore <p>c). Aktivitetet tjera</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkime të pavarura nga studentët 2. Prezantimi i rezultateve 3. Seminare <p>d). Mjetet e punës: Tekste mësimore, artikuj, harta, tabela, projektori, fletat e punës, materiale të përgatitura nga mësimdhënësi, etj.</p>				
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të disa kriterëve bazë. Studentët do të kenë dy teste provuese me shkrim gjatë mbajtjes së ligjëratave dhe një test (provimin) përfundimtar.</p> <p>Vlerësimi dhe notimi do të bëhet duke marr parasysh suksesin e treguar në teste dhe provimin final si dhe angazhimin e përgjithshëm.</p> <p>Çdo student ka për obligim që të përgatisë dy detyra të shtëpisë si dhe një punim seminarik të cilat së bashku janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm nga kjo lëndë. Tema e detyrave të shtëpisë si dhe e seminarit duhet të caktohet në bashkëpunim me mësimdhënësin e në pajtim me planin mësimorë nga lënda.</p> <p>Nota do të ndërtohet duke marrë për bazë këto kriterë:</p> <table data-bbox="716 1829 1252 1898"> <tr> <td>Detyra e parë & aktiviteti:</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Detyra e dytë & aktiviteti:</td> <td>10%</td> </tr> </table>	Detyra e parë & aktiviteti:	10%	Detyra e dytë & aktiviteti:	10%
Detyra e parë & aktiviteti:	10%				
Detyra e dytë & aktiviteti:	10%				

	Punimi Seminarik 20% Provimi final 50% Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	<p>1. Ligjëratat e mësimdhënësit</p> <p>Literatura në gjuhën angleze</p> <p>2. <i>An Introduction to International Economics: New Perspectives on the World Economy 2nd Edition</i>, by Kenneth A. Reinert, Cambridge University Press, 2020</p> <p>3. <i>International Economics 13th Edition</i>, by Dominick Salvatore, Wiley, 2019.</p> <p>4. <i>International Economics: Theory and Policy</i>, Maurice Obstfeld, Marc Melitz Paul R. Krugman, Pearson Education Limited, 2018.</p> <p>5. <i>International Political Economy</i>, Thomas Oatley, 6th Edition, Routledge Taylor & Francis Group, New York, 2018.</p> <p>6. <i>International Economics</i>, sixteenth edition, by Thomsa A. Pugel, edited by Mc Graë Hill Higher Education, 2018.</p> <p>a). Literatura në gjuhën shqipe:</p> <p>1. <i>Ekonomia Ndërkombëtare, Teoria dhe Politika Ekonomike</i>, Paul L. Krugman, Maurice Obstfeld, Përkthim në shqip nga Kolegji VICTORY, Prishtinë, 2010.</p> <p>2. <i>Biznesi Ndërkombëtar, Botimi i dytë</i>, Ilia Kristo, Tiranë, 2004.</p> <p>3. <i>Tregtia Ndërkombëtare, Teoria dhe Politika</i>, Ahmet Mançellari, Tiranë, 2004. Shtëpia botuese Dituria, Tiranë.</p> <p>4. <i>Marrëdhëniet Ndërkombëtare</i>, Joshua S. Goldstein, Përkthim nga Arian e Teuta Starova, Tiranë, viti 2003.</p>
Literatura shtesë:	<p>b). Në gjuhën Angleze</p> <p>1. <i>International Economisc</i>, 12th edition, by</p>

	<p>Domenik Salvatore, 2016.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Global Political Economy, Fifth Edition, John Ravenhill, Oxford University Press, 2017. 3. International Trade & The World Economy, Oxford University Press, 2003. 4. Globalization & International Political Economy, by Mark Rupert & M. Scott Solomon, Published by Roëman & Littlefield Publishers, Inc. 2006. 5. Globalization in Question, by Paul Hirst and Grahame Thompson, Polity press, 2006. 6. <i>The Politics of International Economic Relations 7th Edition</i>, Joan Edelman Edelman Spero, Jeffrey A. Hart, Cengage Learning, 2009. <p>c). Në gjuhën kroate, serbe</p> <ol style="list-style-type: none"> 7. Medjunarodna Ekonomija, Ekonomski Fakultet Zagreb, 2000 8. Uvod u Medjunarodnu Ekonomiju, Grup autorësh, Fakulteti Ekonomik, Beograd, botimi i pestë, 2005.
--	--

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njoftimi me student, prezantimi i mësimeve, prezantime hyrëse lidhur me lëndën dhe programin mësimor, njoftimi lidhur me metodologjinë e punës, vlerësimin dhe notimin. Prezantimi hyrës i Ekonomisë dhe Politikës Botërore, Fitimi nga tregtia, Modelet e tregtisë, Bilanci i pagesave, Përcaktimi i shkallëve të këmbimit të valutave, Koordinimi i politikave ndërkombëtare, Tregu ndërkombëtar i kapitalit.
Java e dytë:	Teoritë Klasike , Pikëpamja merkantiliste për tregtinë, Teoria e Smithit e Avantazheve Absolute, Teoria e Rikardos e Avantazheve Krahasuese, Teoritë Neoklasike Për Tregtinë, Ekonomia Neoklasike, Struktura e Përgjithshme Modelit Neoklasik, Struktura e Prodhimit, Faktori i Çmimit, Vëllimi i Prodhimit, Faktori i Begatisë
Java e tretë:	Ekonomia e shkallës, Konkurrenca perfekte dhe tregtia

	<p>ndërkombëtare Ekonomia e shkallës dhe tregtia ndërkombëtare, Teoria e konkurrencës jopërfekte, Konkurrenca monopolistike dhe tregtia, Dampingu, Teoria e ekonomisë eksterne.</p>
<i>Java e katërt:</i>	<p>Lëvizja ndërkombëtare e faktorëve të prodhimit Lëvizja ndërkombëtare e punës, Huazimi dhe huamarrja ndërkombëtare, Investimet e drejtpërdrejta dhe firmat multinacionale.</p>
<i>Java e pestë:</i>	<p>Instrumentet e Politikës Tregtare Analizat bazë të tarifave, Kostot dhe përfitimet e tarifave, Instrumentet tjera politikave tregtare.</p>
<i>Java e gjashtë:</i>	<p>Ekonomia Politike e Politikës tregtare Tregtia e lirë, Mirëqenia nacionale dhe tregtia e lirë, Shpërndarja e të ardhurave dhe tregtia e lirë, Negocimi ndërkombëtar dhe politika tregtar,</p>
<i>Java e shtatë:</i>	<p>Kontabiliteti i të ardhurave kombëtare dhe Bilanci i Pagesave Llogaria e të ardhurave kombëtare, Kontabiliteti i të ardhurave kombëtare për një ekonomi të hapur, Llogaria e bilancit të pagesave.</p>
<i>Java e tetë:</i>	<p>Shkalla e këmbimit dhe tregu i këmbimit ndërkombëtar Shkalla e këmbimit dhe transaksionet ndërkombëtar, Tregu i këmbimit ndërkombëtar, Kërkesa për valuta të huaja, Ekuilibri në tregun e këmbimit të ndërkombëtar, Shkallët e interesit, pritjet dhe ekuilibri.</p>
<i>Java e nëntë:</i>	<p>Paraja, shkallët e interesit, dhe shkallët e këmbimit Paraja, kërkesa për para, kërkesa agregate për para, Shkalla e interesit e ekuilibrit, Furnizimi me para dhe shkalla e interesit në afat të shkurtër, Paraja, niveli i çmimeve, dhe shkalla e këmbimit në afat të gjatë, Inflacioni dhe dinamika e shkallës së këmbimit.</p>
<i>Java e dhjetë:</i>	<p>Shkalla e këmbimit ndërkombëtar dhe intervenimi në këmbimin ndërkombëtar Intervenimi i Bankës Qendrore dhe oferta e parasë, Si Banka Qendrore e fikson shkallën e këmbimit, Politikat stabilizuese më shkallën fikse të këmbimit, Bilanci i Pagesave, Valutat</p>

	rezervë në Sistemin Monetar ndërkombëtar, Standardi i arit.
Java e njëmbëdhjetë:	Sistemi ndërkombëtar monetare Objektivat e politikës makroekonomike në ekonominë e hapur, Periudha në mes të dy luftave botërore 1918-1939, Sistemi i Breton Wood-sit dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.
Java e dymbëdhjetë:	Politikat makroekonomike dhe koordinimi nën Sistemin e shkallëve lëvizëse të këmbimit Arsyet për shkallë të këmbimit lëvizëse, Politika monetar autonome, Arsyet për shkallë të këmbimit fikse, ndërvarësia makroekonomike nën sistemin e shkallës lëvizëse të këmbimit.
Java e trembëdhjetë:	Hapësira optimale monetare dhe përvoja e Evropiane Si ka lind valuta evropiane, Euro dhe Politika ekonomike në Euro zonë, Teoria e hapësirës optimale monetare, Ardhmëria e Unionit Monetar Evropian.
Java e katërbëdhjetë:	Tregu global i kapitalit, Përformansa dhe problemet e politikave Tregu ndërkombëtar i kapitalit dhe fitimet nga tregtia, Afarizmi ndërkombëtar bankar dhe tregu ndërkombëtar i kapitalit, rregullimi i afarizmit ndërkombëtar bankar, Si ka përformuar tregu ndërkombëtar i kapitalit.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vendet e zhvilluara, rrita, krizat dhe reformat Të ardhurat, pasuria dhe rrita në ekonomin botërore, Karakteristikat strukturale të vendeve të zhvilluara, huazimet dhe borxhet e vendeve të zhvilluara, Mësimet e krizës së vendeve të zhvilluara, reformimi i arkitekturës së financave ndërkombëtare.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët me qëllim të arritjes së suksesit të lartë në studime duhet që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të vijojnë rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet e parapara 2. Të marrin pjesë në mënyrë aktive në ligjëratat përmes pyetjeve, debateve dhe formave tjera të veprimit interaktiv 3. Në marrëveshje me mësimsdhënësin të punojnë dhe të prezantojnë publikisht një punim seminarik prej 12-15 faqe. 4. Në marrëveshje me mësimsdhënësin të punojnë dy detyra të shtëpisë prej 2-2.5 faqe.

5. Të marrin pjesë në testet e ndërmjetme si dhe në testin përfundimtar
6. Gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, testeve apo provimeve kanë për obligim që t'i nënshtrohen kodit të mirësjelljes (mbajtja e qetësisë në mësim, hyrja me kohë në sallë, lëshimi i sallës me pëlqimin e mësimitdhënësit, etj).